



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 468/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Shefqet Balajt dega në Istog, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 03.11.2013, PDK-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, me datë 03.11.2013, në ora 13:00, në Qendrën e Votimit QV nr.06022C personi Shefqet Balaj ka votuar në emër të personit të vdekur, pra të babait të tij Rexhë Balaj. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se është shkelur dispozita e nenit 33 pika j e LZP-së.

PZAP-i, pasi që ftoi në cilësi të dëshmitarit Asllan Balaj- Kryesues i vendvotimit ka deklaruar se, kamë qenë prezent në qendrën e votimit nr.0162201R dhe Shefqet Balaj nuk ka votuar në vend të babait të vet, pasi që kamë qenë afër kurr e ka nënshkruar, pra ka qenë një gabim për të cilin rast kamë informata se në librin e votimit qdo gjë është shkruar në rregull.

Për më tepër ka shtuar se, e kemi shikuar listën e votuesve dhe emëri i Rexhë Balajt nuk ekziston.

I ftuari tjetër në cilësi të dëshmitarit Beqir Asllan Blakaj – Menaxher i Zgjedhjeve në Qendrën Votuese nr.06002C ka deklaruar se, unë nuk jamë i njoftuar në lidhje me këtë rast nga PDK-ja as nga kryesuesi i LVV-së Asllan Balaj – Përfaqësues i VV, prandaj nuk ka pasur asnjë ankesë nga subjektet politike apo kryesuesit në vendvotim dhe ne kemi theksuar se në dy qendrat e VV procedura e votimit ka rrjedhë në mënyrë të rregullt.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : *“Mund të apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Me ankesën e parashtruar nga PDK-ja pretendohet se në Prizren, në Qendrën e Votimit QV nr.06022C personi Shefqet Balaj ka votuar në emër të personit të vdekur, pra të babait të

tij Rexhë Balaj. Mirëpo theksimet e lartcekura janë të pa baza pasi që nuk ekziston asnjë dëshmi me të cilën do të vërtetohej se është kryer një veprim i ndaluar. PZAP-i, konstatoi se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, sepse nga deklaratat e dëshmitarëve theksohet se nuk ka pasur asnjë problem dhe mbarëvajtja e procesit zgjedhorë ka kaluar në mënyrë të rregullt, me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 468/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.